



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.50

Prishtinë, më 5.2.2019, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Xhevahire Izmaqu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Arben Gashi dhe Jelena Bontiq.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Pjetër Boçi, qytetar; Emineta Vllahu, Kallxo.com; Ermira Osmani, RTK; Arbër Hajdari dhe Burbuqe Ibishi, Kosova Press; Rreze Hoxha, GLPS; Fitore Ademi, Rtv 21; Jeton Alshiqi, Kosova sot; Besiana Dauti, Ekonomia Online; Blerta Bejtullahu, Shaban Murturi dhe Edita Kusari, EUSR/EUO; Artan Murati dhe Albert Haliti, KDI; Florim Shefqeti, Oda e Avokatëve të Kosovës; Blerim Sallahu, Kuvendi i Kosovës; Jetmir Bakija dhe Arbelina Dedushaj, D+; Sanije Berisha, OSBE.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit

**Nga stafi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raporti i punës së komisionit për vitin 2018;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së komisionit për vitin 2019;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-140 për ekzekutimin e sanksioneve penale;

5. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit të veprimit;
6. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
7. Shqyrtimi i ankesës për anulimin e konkursit të Shërbimit Korrektues të Kosovës për pranimin e 120 rekrutëve nga Ministria e Drejtësisë;
8. Shqyrtimi i shkresave të Federatës Sindikale të Administratës Publike të Kosovës me emërtimin SPAK;
9. Shqyrtimi i kërkesës lidhur me kallzimin penal të ushtruar me 18.10.2017;
10. Shqyrtimi i shkresës për përkujdesjen e pastërtisë së figurës së personit gjatë përzgjedhjes së kandidatëve në vende pune me autorizime shtetërore;
11. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të Judikaturës së Kosovës;
12. Shqyrtimi i kërkesës nga Pjetër Boçi, drejtuar komisionit;
13. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### 2. Raporti i punës së komisionit për vitin 2018

**Kryetarja** paraqiti raportin e punës së komisionit për vitin 2018, ku ndër të tjera spikat numri i 22 projektligjeve të trajtuara, si Komision funksional, për këtë vit. Po ashtu, tha se ka pasur ngecje për monitorim të ligjeve, por si komision kemi qenë shumë të ngarkuar dhe ka qenë e pamundur që të mbikëqyret ndonjë ligj që është në fuqi.

*Kryetarja konstatoi se raporti i punës së komisionit u miratua njëzëri nga anëtarët e komisionit, për vitin 2018.*

### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së komisionit për vitin 2019

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim dhe miratim planin e punës së komisionit për vitin 2019 dhe tha se ky draft-plan i punës është hartuar nga stafi i komisionit. Këtu janë paraparë projektligjet që janë në strategjinë legjislative, po ashtu janë paraparë dëgjime publike, vizita në terren. Më tej, tha se është urgjente mbikëqyrja e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, sepse ka shumë probleme me këtë ligj në praktikë, ku Kuvendi e ka miratuar në prill të vitit të kaluar. Ndonëse nuk është kohë e gjatë që kur ka hyrë në fuqi, por kemi shumë probleme. Gjithashtu, edhe sa i përket Ligjit për procedurën përmbare, në praktikë janë shfaqur shumë probleme, sepse është shndërruar në torturë për qytetarët e Republikës, për shkak të mosrespektimit të dispozitave ligjore nga disa përmbareues privatë, prandaj do ishte mirë që komisioni të monitorojë zbatimin e këtij ligji. Ndërsa, sa i përket dialogut me Serbinë, kërkesa e KDI-së është që të bëhet plan i punës dhe raportimi i ministrave, që komisioni të merret me çështjet brenda fushëveprimtarisë që lidhen në raport me bisedimet. Më pas, kryetarja hapi diskutimin për antarët e komisionit.

**Hajdar Beqa**, tha se sa i përket monitorimit të zbatimit të ligjit, komisioni ka qenë shumë i ngarkuar dhe deklaroi se e përkrah këtë plan të punës, por tha se nëse ka rrethana të reja gjatë punës së komisionit, ky plan i punës mund të ndryshohet dhe të plotësohet.

**Korab Sejdiu**, tha se qartësisht duket që agjenda është shumë ambicioze nga numri i ligjeve që do të kalojnë nëpër duart tona dhe disa do jenë ngarkesë shtesë, për arsye të volumit të ligjeve, siç është Projekt-Kodi i Procedurës Penale dhe Projekt-Kodit Civil. Ndërsa, sa i përket zbatimit të ligjeve, tha se duhet të synojmë që mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të bëhet në tërë sektorin që është në kuadër të fushë veprimtarisë së komisionit dhe duke pohuar se asnjë prej ligjeve nuk zbatohet as nga afër, duke filluar nga Gjykata Kushtetuese, KGJK, KPK, andaj propozoi që të ftohen personat përkatës për institucionet që po dështojnë në zbatim të ligjeve. Po ashtu, tha se rrjedhimisht ua mohojnë të drejtat elementare të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të kërkohet prej tyre arsyet se pse nuk ka zbatim të plotë të ligjeve.

**Kryetarja**, tha se sa i përket vizitave në institucionet përkatëse, duhet të merren në konsideratë ku janë pritur përfaqësuesit e institucioneve që bien në fushëveprim të komisionit, por megjithatë duhet të lëvizim edhe në terren dhe të ushtrojmë detyrën, si komision. Po ashtu, tha se propozimi i z. Sejdiu edhe mund të inkuadrohet në plan të punës, qoftë të ftohen apo anëtarët e komisionit të dalin në terren. Sa i përket Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit u dakorduan që në muajin mars të niset me mbikëqyrje të zbatimit të këtij ligji, dhe më pas, në pjesën e dytë të këtij viti, e nisim me monitorim të Ligjit për përmbarrimin privat. Ndërsa, sa i përket kërkesës së KDI-së, brenda këtij plani të punës, ne mund të adresojmë çështje të fushëveprimit të komisionit, sa i përket dialogut me Serbinë. Në fund, tha se edhe pse kemi dallime të madha në raport me procesin e dialogut, plani aktual mund të plotësohet dhe ndryshohet dhe pastaj mund të bëjmë diçka në drejtim të mbikëqyrjes së kësaj.

**Frashër Krasniqi**, tha se dua t'i japë mbështetje, me deklaratë, kërkesës së KDI-së dhe konsideroi që zhvillimi më i rëndësishëm në raport me dialogun me Serbinë është fakti është që ky dialog do t'i nënshtrohet monitorimit të drejtpërdrejtë nga Kuvendi. Megjithëse, do të krijohet një komision i veçantë për këtë punë dhe është e domosdoshme që dialogu të monitorohet dhe të raportohet për dialogun në të gjitha komisionet. Po ashtu, tha se ky është një hap shumë i rëndësishëm dhe pozitiv, prandaj kërkesa e KDI-së është në përputhje me këtë frymë të dialogut, ku Kuvendi e ka rolin drejtues.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se anëtarët e komisionit votuan njëzëri planin i punës për vitin 2019.*

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-140 për ekzekutimin e sanksioneve penale**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim, në parim, Projektligjin nr. 06/L-140 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe tha se është më i avancuar, duke pohuar se do të ndalet në dy çështje që janë hasur në vizitat në terren nëpër qendrat korrektuese. E para, kërkesat kryesore të të burgosurve janë që ta kenë të drejtën e pakos së ushqimit dhe arsyetimi se pse është hequr pakoja e ushqimit për të burgosurit, ka qenë për të ndaluar kontrabandën. Më tej, tha se kur kemi qenë

në vizitë, si komision, në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i kemi parashtruar edhe këtë pyetje, se a është ndaluar kontrabanda me këtë ndalesë dhe ata janë përgjigjur se kontrabandën mund ta ndalojnë skanerët e avancuar, për të cilët asnjëherë nuk është ndarë buxhet. Prandaj, ka qenë kërkesë e vazhdueshme që ata ta kenë të drejtën e pakos së ushqimit. Po ashtu, ditët e pushimit janë shtuar, nga shtatë, diku në katërmbëdhjetë e diku edhe në njëzetë e një, që njëkohësisht ka qenë kërkesë e të burgosurve, që vlerësohet pozitivisht për përfshirje në projektligj. Në fund, tha se në parim duhet ta përkrahim këtë projektligj dhe në grupet e punës t'i adresojmë disa çështje që janë kundërtënëse dhe ndërhyrje në kompetenca të institucioneve dhe kërkoj nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

**Sami Kurteshi**, tha se si monitorues i burgjeve, prej të kaluarës profesionale, është bërë një përpjekje shumë e mirë, por duhet të punohet në këtë projektligj, sepse ka të bëj me pozitën e njerëzve, që nuk kanë mundësi aq shumë të reagojnë për gjendjen e tyre, por edhe për të ardhmen e tyre. Më tej, shtoi se më shumë shihet pjesa e sanksioneve për të burgosurit, pra mungon edhe një përpjekje shtesë e shoqërisë për t'i rehabilituar, risocializuar këto njerëz, për t'i kthyer, siç kanë qenë, pjesëtarë të barabartë dhe të vlefshme të kësaj shoqërie.

**Frashër Krasniqi**, tha se Republika e Kosovës, në teori, është shtet që ka zgjedhur të jetë rehabilitues dhe korrektues, në raport me krimin, por në praktikë më shumë është sistem ndëshkues sesa riedukues. Kishte vërejtje, sidomos në çështjen e pakove, që në praktikën e vendeve perëndimore, pakot nuk parashihen të përfshihen, por nëse e marrim parasysh gjendjen shumë të rëndë në aspektin e ushqimit në burgjet e Kosovës, mendon që së paku si dispozitë kalimtare do të duhej të përfshihej edhe pakoja. Më pas, konsideroi se çështja e ushqimit dhe shëndetësisë nëpër burgje janë në gjendje shumë të rëndë. Po ashtu, ditët e pushimit duhet të jenë njëzet e katër në vit, që do të nënkuptonte dy ditë në muaj. Më tej, propozoi se një prej elementëve që duhet të përfshihet në dëgjime publike janë edhe të burgosurit, duke i vizituar ata, që të marrin edhe mendimin e tyre, sepse edhe të burgosurit mund ta thonë fjalën e tyre për këtë projektligj.

**Hajdar Beqa**, tha se është një punë e mirë që e ka bërë Ministria e Drejtësisë. Ne kemi pasur rastin, si anëtarë të komisionit, t'i vizitojmë edhe të burgosurit dhe kemi parë se cilat janë kërkesat e tyre elementare. Propozoi që të përkrahët, në parim, ky projektligj dhe kontributin, vërejtjet dhe sugjerimet të jepen në grup të punës.

**Bilall Sherifi**, tha se projektligji i plotëson standardet për t'u përkrahur nga komisioni, në parim, dhe pastaj në grupet punuese. Më tej, tha të burgosurit nuk janë në ato përmasa që të trajtohen veç si kriminelë dhe natyrisht se ndëshkimi është pjesë e sanksioneve. Po ashtu, tha se do të duhej të respektoheshin liritë dhe të drejtat e njeriut gjatë periudhës sa janë të dënuar dhe në funksion të kësaj duhet të ketë kujdes, në këtë drejtim. Sipas z. Sherifi, duhet të ketë korrektim, pra dhënie të mundësisë që të burgosurit që të përmirësohen. Në fund, tha se kemi shumë probleme në lidhje me krimin dhe përmes këtij ligji u jepet përgjigje shumë pyetjeve që deri më tani nuk janë dhënë.

**Sami Kurteshi**, tha se nuk e rregullon çështjen e trajtimit të njeriut për kufizim të lirisë, në përgjithësi. Më tej, tha se kjo çështje nuk rregullohet vetëm me këtë ligj, por kjo ka të bëjë vetëm me atë pjesën sesi këta njerëz të trajtohen, pasi të jenë dënuar nga gjykata. Në fund, tha se qëllimi është që sa më mirë të trajtohen ata njerëz, shoqëria ka benefite të mëdha.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet, në parim, Projektligji nr.06/L-140 për ekzekutimin e sanksioneve penale.

#### **5. Formimi i grupit punues për shqyrtimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit të veprimit**

**Kryetarja**, tha se te Strategjia Kundër Korrupsionit, kemi pasur një problem, sepse Qeveria e pati miratuar dhe nuk e pati sjellë fare në Kuvend. Pra, menjëherë e ka autorizuar Agjencinë Kundër Korrupsionit për zbatim dhe monitorim të strategjisë. Kjo ka qenë e paprecedent, sepse ligji e thotë që Kuvendi duhet ta miratojë strategjinë. Ne, si komision, kemi bërë përpjekje dhe disa herë i kemi shkruar Qeverisë, për ta sjellë strategjinë dhe tash e ka sjellë, në fund të dhjetorit. Ju po e shihni që strategjia është 2018-2022, por tashmë 2018-ta ka shkruar, prandaj duhet ta formojmë grupin punues, që ta ndryshojmë edhe vitin, edhe aktivitetet.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, mori këtë:*

### **V e n d i m**

#### **Për formimin e grupit të punës për shqyrtimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit të veprimit:**

1. Formohet grupi punues për shqyrtimin e Strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2018-2022 dhe Planit të veprimit, në përbërje:

1. Albulena Haxhiu, kryesuese,
2. Hajdar Beqa, anëtar, dhe
3. Korab Sejdiu, anëtar.

#### **6. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim raportin e komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

*Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që:*

*Projektligji nr. 06/L-091 për plotësim-ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të procedohet për seancë.*

## **7. Shqyrtimi i ankesës për anulimin e konkursit të Shërbimit Korrektues të Kosovës për pranimin e 120 rekrutëve nga Ministria e Drejtësisë**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim ankesën për anulimin e konkursit të Shërbimit Korrektues të Kosovës për pranimin e 120 rekrutëve nga Ministria e Drejtësisë dhe tha se çështja është lidhur me një konkurs që ka shpallur ministria, në raport me Shërbimin Korrektues të Kosovës. Në bazë të shkresës, konsiderohet që kandidatët janë zgjedhur në bazë të nepotizmit, bindjeve politike, me interes të dyshuar edhe për korrupsion.

**Hajdar Beqa**, theksoi se ne kemi një legjislacion në fuqi dhe procedurat për rekrutimin e punëtorëve të rinj, pavarësisht në cilin institucion, duhet të shkojnë në harmoni me procedurat e legjislacionit në fuqi. Po ashtu, tha se të pakënaqurit duhet të iu drejtohen organeve kompetente sepse nuk është në kompetencën tonë të marrim pjesë as në monitorim të konkursit e as të intervistave por as të përzgjedhjeve. Në fund tha se i inkurajoj që të drejtohen te inspektorati i punës nëse vlerësohet se ka pas shkelje sepse kjo është rruga ligjore.

**Sami Kurteshi**, tha se çdo qytetar ka të drejtë t'u drejtohet përfaqësuesve që i ka zgjedhur me votë. Ata kanë të drejtë t'u drejtohen komisioneve dhe ne kemi të drejtë për t'i shqyrtuar kërkesat e tyre jemi apo nuk jemi kompetentë. Më tej, propozoi që pasi komisioni nuk është kompetent për të shqyrtuar kërkesën, kjo kërkesë mund t'i adresohet Komisionit për të Drejtat e Njeriut, për ta shqyrtuar këtë kërkesë, nëse ka shkelje.

**Bilall Sherifi**, tha se shqyrtimi i kërkesës duhet të bëhet gjithsesi. Nëse nuk mund të ndërhyjmë në procedurat, të cilat janë zhvilluar, por kemi të drejtë që me shkrim t'u kthejmë përgjigjen në formë të këshillave sesi duhet të veprojnë. Por, vetëm të thuhet që nuk është në kompetencën tonë. Pra, nuk do të ishte korrekte, sepse jemi komision që shqyrtojmë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë.

**Xhevahire Izmaku**, tha se natyrisht, ne nuk jemi kompetentë, por propozoi që komisioni t'i kthejë përgjigje dhe ta orientojë qytetarin se ku duhet të bëjë ankesë.

**Kryetarja** theksoi se nuk e ka parë listen e të punësuarve, prandaj duke pasur parasysh që është një ankesë jo dosido, mendoj se duhet ta trajtojmë në veçanti. Prandaj, propozoi që të formohet një grup i punës që merret me këtë çështje, por në qoftë se ju nuk jeni dakord atëherë administrata mund të përgatisë një përgjigje, që e orienton se kush janë institucionet përkatëse dhe më pas secili individualisht mund të shohim se çka mund të bëjmë.

**Korab Sejdiu**, tha se nëse shikohet në aspekt të individualizmit, atëherë ne duhet t'i njoftojmë ata se ne nuk jemi kompetentë për t'i adresuar ankesat e tyre individuale dhe t'i drejtojmë tek organet kompetente. Ndërsa, si problem kolektiv duhet të shikohet se kush është përgjegjës, nëse e shohim nëse një organ shtetëror nuk po i zbaton procedurat e angazhimit në punë të zyrtarëve të tyre. Më tej, propozoi që Komisioni për Administratë Publike, duhet t'i ftojë organet përkatëse përgjegjëse për moszbatim të ligjit.

**Shkumbin Demaliaj**, tha se po flasim për një ankesë që ka të bëjë me një anulim konkursi dhe jo për shkeljen e të drejtave në punë. Këtë e përcakton mirë Ligji i punës. Sipas deputetit Demaliaj, këta duhet t'i drejtohen Inspektoratit të punës, në shkallë të parë, dhe nëse nuk konstatohet se ka pasur shkelje, atëherë mundet të drejtohen edhe në shkallë të dytë. Pas shkallës së dytë, duhet t'i drejtohen gjykatës.

*Në lidhje me këtë pikë, anëtarët e komisionit u dakorduan që të hartohet një draft për kthim të përgjigjes, dhe në mbledhjen e radhës, të trajtohet drafti i përgatitur.*

## **8. Shqyrtimi i shkresave të Federatës Sindikale të Administratës Publike të Kosovës me emërtimin SPAK**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim shkresat e Federatës Sindikale të Administratës Publike të Kosovës me emërtimin SPAK dhe tha se jo rrallëherë e kemi trajtuar këtë kërkesë, duke pohuar se ka të bëjë me stazhin e punës që është pesëmbëdhjetë vjet dhe është konsideruar si diskriminim, ku është kërkuar nga komisioni që të adresojë këtë çështje. Po ashtu, tha se nuk jemi kompetentë për ta trajtuar këtë shkresë. Ne i kemi shkruar disa herë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, por në anën tjetër, nuk e ka adresuar këtë. Siç e keni parë në seancë plenare, ka qenë një debat për këtë problem, gjegjësisht shfuqizim të këtij udhëzimi për stazhin e punës. Ne e kemi trajtuar edhe vetë brenda subjektit tonë dhe kemi konsideruar që nuk duhet të ketë kufizim me vite, për t'u njohur stazhi. Ka pasur padrejtësi, në këtë aspekt, por edhe njëherë ne duhet t'ia adresojmë Komisionit për Shëndetësi dhe të kërkojmë nga komisioni, që të na njoftojë se a ka bërë diçka në këtë drejtim, sepse shqetësimi më i madh, sa iu përket këtyre kategorive, ka qenë kjo, pra stazhi i punës që nuk u është njohur. Duhet t'i kenë pesëmbëdhjetë vite, për t'ua njohur përvojën. Çështje tjetër që duhet ta trajtojmë, është se kur fëmija mbush 5 vjet, atëherë ndalet ndihma për atë familje dhe kjo është absurde, sepse fëmija kur të rritet ka shpenzime më të mëdha.

**Sami Kurteshi**, tha se është marrë me këtë çështje edhe sa ka qenë në funksion tjetër. Kjo është një shkelje shumë e rëndë e të drejtave të njeriut. Pensioni është e drejtë legjitime dhe pronë e secilit person. Përcaktimi arbitrar pesëmbëdhjetë vjet, përndryshe nuk të pranohet stazhi i punës. Kjo është një vjedhje e drejtëpërdrejtë e njerëzve që kanë paguar kontribute pensionale. Nuk mund t'i mohohet askujt, për të realizuar të drejtën e vet për pensionim, duke thënë se udhëzimi është në shpërputhje me ligjin dhe me Kushtetutën. Në fund, tha se ne duhet të bëjmë përpjekje që njerëzve t'u njihet kjo e drejtë legjitime.

**Hajdar Beqa**, tha se pajtohet me kolegët, se kjo çështje është shumë serioze, dhe në bazë të informacioneve që kemi nga terreni, është shqetësim që nuk i njihet stazhi punëtorëve që kanë punuar, ndoshta diku tjetër kur i kanë larguar nga puna në vitet e 90-ta, ndërsa ata që kanë punuar nën masa të dhunshme iu njihet e drejta. Prandaj, rekomandoi që t'i drejtohem Komisionit për Shëndetësi që të marrë një nismë ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale. Në fund, tha se duhet t'i përkrahim, por të gjejmë rrugën ligjore dhe jo me deklaratat politike, por të marrim vendime konkrete.

**Shkumbin Demaliaj**, theksoi se iniciativa, çdo ditë, është që të ulet pragu, por nëse tentohet të ulet pragu, atëherë është mirë të hiqet ai prag, krejt. Ai njeri që ka punuar duhet t'i njihet e drejta e tij në punë. Po ashtu, tha se ky problem duhet të zgjidhet njëherë e përgjithmonë dhe të bëhet debat i sinqertë dhe jo debat politik i hapur.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni vendosi që t'i drejtohet Komisionit për Shëndetësi, si vijon:*

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në lidhje me këtë shkresë, nuk është në fushëveprim të komisionit, ndaj vendosi t'i rekomandojë Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të ndërmarrë nismën ligjore për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale, të financuara nga shteti.

Gjithashtu, komisioni propozoi që, kur të trajtohet kjo shkresë në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të ftohet edhe një anëtar i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

#### **9. Shqyrtimi i kërkesës lidhur me kallzimin penal të ushtruar më dt. 18.10.2017**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim kërkesën lidhur me kallzim penal të ushtruar me dt. 18.10.2017 dhe tha se problemi është që në momentin kur diçka procedohet në institucionet e drejtësisë, në këtë rast, bëhet një kallzim penal dhe ne si komision nuk e kemi më fushëveprim. Kërkesa është që personi në fjalë ka bërë një kallzim penale dhe pastaj nuk është bërë asgjë, në këtë drejtim. Flitet për presione nga njerëz të përveçëm dhe ka kërkuar nga komisioni që të merremi me këtë, por ne nuk kemi kompetencë që të merremi me këtë çështje.

*Kryetarja konstatoi se anëtarët e komisionit vlerësuan se është jokompetente, që të merren me këtë çështje.*

#### **10. Shqyrtimi i shkresës për përkujdesjen e pastërtisë së figurës së personit gjatë përzgjedhjes së kandidatëve në vende pune me autorizime shtetërore**



**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim shkresën për përkujdesje të pastërtisë së figurës së personit gjatë përzgjedhjes së kandidatëve në vende pune, me autorizime shtetërore dhe tha se kjo shkresë ka ardhur nga z.Sadri Hamëz Mazreku nga Malisheva. Më tej, tha se është kërkesë që lidhet edhe me projektligjin që është miratuar, në parim, për pastërtinë e figurës. Në momentin kur ne e trajtojmë atë projektligj, natyrisht mund ta ftojme atë edhe në grupe të punës, të cilat janë të hapura për publikun.

**Sami Kurteshi**, tha se personin në fjalë e njeh dhe ka një kohë të gjatë që merret me shkresa të tilla. Po ashtu, tha se duhet t'u drejtohet institucioneve përkatëse dhe gjithashtu mendon që nuk është person adekuat për ta ftuar në grupe të punës, në lidhje me projektligjin në fjalë.

*Pas diskutimeve, anëtarët e komisionit u pajtuan që ta njoftojnë që projektligji është duke u shqyrtuar dhe në momentin kur ai projektligj hyn në fuqi, pastaj kushdo që bie ndesh me të, nuk mund të bartë asnjë pozicion në Kosovë.*

## **11. Shqyrtimi i shkresës së Sindikatës së Pavarur të Judikaturës së Kosovës**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim shkresën e Sindikatës së Pavarur të Judikaturës së Kosovës dhe tha se Ligji për pagat është miratuar në Kuvend, por megjithatë duhet të merremi, sepse Administrata e Prokurorisë Speciale janë në grevë, sepse thuhet që 50% u janë zbritur rrogat. Është krijuar shumë pabarazi dhe diskriminim përbrenda sidomos te sistemi i drejtësisë, ku një zëdhënës apo një zyrtar ligjor marrin paga 300-400 euro ndërsa prokurorët dhe gjyqtarët paguhen shumë më shumë dhe prandaj kjo ka krijuar pakënaqësi. Po ashtu, theksoi se amendamenti që ishte për shtesat e posaçme në administratë, në sistemin e drejtësisë, nuk mori përkrahje nga deputetët e Kuvendit. Gjithashtu, tha se ata kanë paralajmëruar grevë dhe ne nuk mund të heshtim përballë këtij diskriminimi dhe situatës së krijuar. Është e rëndësishme të theksohet se këta kanë qenë në grevë në muajin korrik, sepse edhe i kemi vizituar dhe i kemi pritur në komision. Po ashtu, theksoi se kanë marrë premtime nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial dhe ministri i Drejtësisë, që kërkesat e tyre do të zbatohen, por asnjëra prej tyre nuk është adresuar. Më tej, tha se Ligji për pagat, tetë ditë është afati për ta kontestuar në gjykatë, pastaj dekretohet, shpallet në gazetë zyrtare, dhe pas 9 muajve, hyn në fuqi. Në këtë situatë, e vetmja mundësi që kemi, është që kur ligji të hyjë në fuqi, të shohim mundësinë e adresimit të kërkesave të tyre, sepse pa hyrë ligji në fuqi, ne nuk mund të ndryshojmë asgjë. Në fund, tha se kjo është e padrejtë, për shkak të ngarkesave dhe punës specifike që ka administrata e sistemit të drejtësisë, prandaj ne duhet të shohim sesi po vijon situata.

**Hajdar Beqa**, tha se pa hyrë ligji në fuqi, nuk kemi si të veprojmë dhe nuk kemi pasur reagim konkret të dikujt për ligjin. Po ashtu, tha se në disa pika nuk jam pajtuar me këtë ligj, duke pohuar se i mbështet kërkesat e Sindikatës së Pavarur të Judikaturës.

**Kryetarja** theksoi se me këtë çështje është dashur të merret Ministria e Drejtësisë, e cila edhe u ka premtuar, por nuk ka bërë asgjë, në këtë drejtim. Por, megjithatë, duhet të konsiderojmë si goxha serioze situatën e krijuar dhe ne duhet të veprojme në përputhje me rrethanat që i kemi.

*Pas diskutimeve, komisioni konstatoi se pa hyrë ligji në fuqi, nuk mund të ndërmerret asgjë, në këtë drejtim, edhe pse situata e krijuar është shumë serioze.*

## **12. Shqyrtimi i kërkesës nga Pjetër Boçi, drejtuar komisionit**

**Kryetarja** paraqiti për shqyrtim kërkesën e Pjetër Boçit dhe tha se i është drejtuar me kërkesë, që t'i japim përgjigje, si komision, se a është person zyrtar apo jo. Në fakt, punon në një biznes privat dhe gjykata e ka vlerësuar si person zyrtar dhe të njëjtën shkresë e ka proceduar edhe në Ministri të Drejtësisë dhe ministria i ka kthyer përgjigje, që nuk është person zyrtar dhe nuk mund të emërtohet si i tillë, sepse nuk është i punësuar në institucione shtetërore. As legjislacioni në fuqi, që rregullon këtë çështje, nuk e përcakton si person zyrtar, dikë që punon në një biznes privat. Në fund, tha se ky duhet të jetë edhe mendimi i komisionit, sepse konsiderojmë që i njëjti nuk është person zyrtar.

*Meqë nuk pati vërejtje, komisioni u dakordua që t'i kthehet përgjigje z. Pjetër Boçit, si vijon:*

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në lidhje me këtë shkresë dhe dokumentacionin e ofruar nga z. Pjetër Boçi, i lindur më dt.15.6.1963, me numër të letërnjoftimit 2004729857, vlerësoi se pajtohet me opinionin e dhënë nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë, dt. 11.1.2019.

## **13. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk kishte çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**